




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Smaj Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 10.12.2019 Nr. 020-1213
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Rahovecit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:


Vendim Nr. 17/2019 për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Vlorës

I miratuar më datë: 27.11.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.12.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Obligohet Komuna e Rahovecit që t'i zhvillojë procedurat ligjore për këmbim, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Smajl Latifi, gradonačelnik opštine Orahovac Afrim Dina, predsedavajući Skupštine opštine Orahovac	
Kopija:	Jedinici za administriranje sa dokumentima u MALS-u Jedinici za administriranje sa dokumentima u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini, rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS	Dana, 10.12.2019 Br. 020-1213
Odgovorni službenici:	1. Službenik za potvrđivanje pravne procene Venera Çerkini, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
	2. Službenik za izradu pravne procene Ardita Latifi, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Orahovac	
Vrsta akta:	☐ Odluka skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,

Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 17/2019 o inicijativi međunarodne opštinske saradnje za bratimljenje između opštine Orahovac i opštine Vlora

Usvojena dana, 27.11.2019

Predložena na razmetranje u MALS-u dana, 02.12.2019

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi o lokalnoj samoupravi. Opština Orahovac se obavezuje da razvija zakonske procedure za razmenu, u skladu sa Zakonom br. 06/L-092 o dodeli na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

Nr./No. 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./No. 17/19 Nr. i fletës/Nr. i fletës 1

Data/Date 27.11.2019

Në bazë të nenit 12, 17 dhe 30 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), neneve 10, 39, 40 paragrafi 2 pika 2, 9, 59 dhe 60 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, nenit 6 pika 6, nenit 7 dhe nenit 18 të Ligjit Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal dhe nenit 5 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me nenin 6 të Rregullores për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar Nr. 0203-1334 të datës 18.12.2012, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë: 27.11.2019, merr këtë:

V E N D I M

Për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar për binjakëzim.
2. Nisma e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim do të zhvillohet në mes të dy komunave si në vijim:
 - 2.1. Komunës së Rahovecit, Republika e Kosovës dhe
 - 2.2. Bashkisë së Vlorës, Republika e Shqipërisë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Rahovecit, që të filloj konsultimet për themelimin e marrëveshjes për bashkëpunim komunal ndërkombëtar për binjakëzim në mes të Komunës së Rahovecit, Republikës së Kosovës dhe Bashkisë së Vlorës, Republika e Shqipërisë.
4. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve të hartohet draft marrëveshja për themelimin e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, përkatësisht binjakëzimit në mes dy institucioneve shtetërore dhe atë në kuadër të kompetencave të tyre vetanake dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.
5. Për Zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. 17/2019
Me datë: 27.11.2019





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 132 Nr. i faq/Br.str/No.pg 14

Data/Datum/Date 11 / 11 / 2019

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 6 paragrafi 2 pika 2.1 i Ligjit Nr. 04/L-010 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar i datës 21.07.2011, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.1 të Rregullores Nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër-Komunal dhe neneve 59, 60, 61 dhe 74 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.9 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, propozon:

NISMËN

Për Bashkëpunimin Ndërkomunal Ndërkombëtar

1. Kryetari i Komunës paraqet kërkesën për miratimin e nismës për të hyrë në bashkëpunimin ndërkomunal ndërkombëtar.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunitet e ministrinë si në vijim:
 - 2.1. Komunën e Rahovecit, Republika e Kosovës
 - 2.2. Bashkinë e Vlorës, Republika e Shqipërisë
3. **Qëllimi i bashkëpunimit** – Bashkëpunimi do të bëhet në fushën e trashëgimisë, kulturës dhe ekonomisë.
4. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta të reciprocitetit dhe të përfitimit të shumanshëm me mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës.
5. Bashkangjitur me nismën e gjeni edhe propozim-vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

Arsyetim

Duke u bazuar në vlerat e përbashkëta ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës të Republikës së Shqipërisë në fushën e trashëgimisë, kulturës dhe të ekonomisë për iniciimin e nismës për bashkëpunim ndërkomunal ndërkombëtar, Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit iniciimin e procedurës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet Komunës së Rahovecit, Republika e Kosovës dhe Bashkisë së Vlorës, Republika e Shqipërisë.

Fushat në të cilat do të bashkëpunoj Komuna e Rahovecit dhe Bashkia e Vlorës janë: ekonomia, kultura, arsimi, sporti, shëndetësia, etj.

U dërgohet:

1. Anëtarëve të Kuvendit,,
2. Shërbimit të Kuvendit,
3. MAPL-së,
4. Bashkisë së Vlorës, dhe
5. Arkivit.



Ardita Latifi

From: Blerta Halimi
Sent: Monday, December 09, 2019 1:27 PM
To: Ardita Latifi
Cc: Trim Berisha
Subject: Vendim për binjakëzim_Rahovec
Attachments: Vendim-Rahovec.pdf; Vendim për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës.pdf

E nderuar,

Pas shqyrtimit të Vendimit për nismën e Bashkëpunimit komunal Ndërkombëtarë mes Komunës së Rahovecit dhe Bashkisë së Vlorës janë konform ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Me respekt,

Blerta Halimi
Udhëheqëse e Divizionit për Bashkëpunim Ndër-komunal, Departamenti për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitar, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ndërtesa "ish - Rilindja" - kati XI, Zyra nr.1103
Tel: 038-200 / 35660 Email:blerta.halimi@rks-gov.net

From: Besa Shala
Sent: Thursday, December 5, 2019 8:45 AM
To: Blerta Halimi
Trim Berisha
Subject: FW: Vendim për binjakëzim_Rahovec

Të bashkëlidhur e keni Vendimin për binjakëzim mes Komunës së Rahovecit dhe komunës së Vlorës për të cilin duhet të bëhet konfirmimi i ligjshmërisë nga MAPL-ja

Besa Shala

Zyrtare për promovimin e bashkëpunimit komunal
Departamenti për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitar
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
tel. 038/200 35 573
Adresa: Ish pallati i shtypit "Rilindja"-Kat.11

From: Ardita Latifi
Sent: Wednesday, December 4, 2019 3:18 PM
To: Besa Shala

Cc: Xhevat Tafa

Subject: Vendim për binjakëzim_Rahovec

E nderuar,

Bashkëngjitur gjeni, 1 vendim nga Komuna e Rahovecit:

- **Vendim Nr. 17/2019 për nismën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim midis Komunës së Rahovecit dhe Komunës së Vlorës**

Ju lutem, kërkojmë nga Ju, që të verifikoni se a është në harmonizim me Legjislacion në fuqi, në mënyrë që t'a procedojmë tutje dhe të konfirmojmë ligjshmërinë e aktit në fjalë.

Flm shumë

Ardita



Ardita LATIFI

Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave

Qeveria e Republikës së Kosovës/Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ndërtesa e Qeverisë "ish-Rilindja", kati 11, zyra 11/17

Email: ardita.latifi@rks-gov.net

Nr. Centrix: 038-200-35-629

Prishtina, Republika e Kosovës